

FJALA E DEPUTETIT LULZIM BASHA

E ENJTE 21 KORRIK 2022

Të dashur bashkëqytetarë,

Të dashur bashkëkombës në Kosovë e kudo që na ndiqni,

Sot është një ditë e rëndësishme për këtë institucion, i cili duhet të dëshmojë edhe një herë se Shqipëria nuk mund të ketë interes më të lartë, nuk mund të ketë asgjë më të shenjtë se interesat e Kosovës, se nuk mund dhe nuk do të ketë bashkëpunim të qëndrueshëm rajonal, një të ardhme në paqe të popujve tanë pa pranuar dhe dënuar gjenocidin serb. Ndër vite ka pasur përpjekje të vazhdueshme për të manipuluar faktet, për t'u ikur të vërtetave, siç ka ndodhur edhe me raportin e Dik Martit, një raport fake, dhe tashmë është e qartë se pas tij fshihen strukturat serbe.

Nuk është aspak rastësi, që pasi krijuan një tollovi të madhe në opinionin ndërkombëtar në përpjekje për të ndryshuar historinë, hapi më i fundit, siç e ka pohuar publikisht protagonistin, ishte planifikimi për eliminimin fizik të ishraportuesit të Këshillit të Europës, Dik Marti, nga struktura serbe e sigurisë, për të fshehur gjurmët dhe për të fajësuar sërish shqiptarët. Por e vërteta nuk zhbëhet dot, ajo është shkruar në historinë e dhimbshme të kombit tonë me gjakun e viktimave të pafajshme, të rëna prej gjenocidit serb në Kosovë e po ashtu prej gjakut të të rënëve në mbrojtje të shqiptarëve nga shfarosja. Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ishte një luftë e drejtë përballë agresionit, gjenocidit, spastrimit etnik, krimeve kundër njerëzimit, që regjimi kriminal i Millosheviçit po kryente sistematikisht dhe në mënyrë të planifikuar ndaj popullsisë së pambrojtur në Kosovë.

Askush nuk mund të barazojë viktimën me agresorin, askush nuk mund të barazojë luftën e drejtë të UÇK-së për dinjtet njerëzor dhe liri me masakrat dhe gjenocidin e ushtruar nga hordhitë kriminale të Slobodan Millosheviçit ndaj popullsisë civile të Kosovës. Lufta e UÇK-së pati në krah të saj NATO-n, me në krye SHBA-të, sepse ishte një luftë e drejtë. Shqiptarët patën në krah dhe në mbrojtje të tyre të gjitha vendet demokratike, sepse ndaj tyre po kryhej

gjenocid, spastrimi etnik dhe krimet më çnjerëzore. Prandaj, ky parlament, burrat dhe gratë me integritet nuk e fusin kokën si struci në rërë, nuk mund të kenë asnjë ngurrim për të folur qartë dhe fort dhe për të votuar. Makinaria ushtarake serbe e Milosheviçit ka kryer gjenocid. Ka kryer spastrim etnik në Kosovë.

1600 persona janë ende pa varr edhe sot që flasim. Dënimi i gjenocidit serb në Kosovë nuk ka për qëllim për të mbetur pengje të së shkuarës së dhimbshme, por për t'i hapur rrugën të ardhmes që nuk mund të jetë e paqte dhe e begatë për rajonin pa u shëruar plagët e një lufte që shqiptarët nuk e kanë nisur, por e kanë pësuar. Çdo qëndrim tjetër ndaj Serbisë, sado të fshihet pas sokëllimave të gjuhës së shturur dhe banalitetit të gënjeshtrove, është në fakt një amnisti ndaj një të shkuare që rrezikon të përsëritet nëse nuk pranohet dhe dënohet. Na takon ne të jemi zëri i viktimave të atij gjenocidi dhe zëri i Kosovës. Në këtë mënyrë ne i japim edhe më shumë zë në arenën ndërkombëtare të vërtetës së hidhur të gjenocidit dhe spastrimit etnik të kryer në Kosovë. Në këtë mënyrë jemi krah të përpjekjeve të Kosovës për të mbështetur padinë që ajo po përgatit.